R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.29/2023, "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT", TË NDRYSHUAR"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Propozimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar" mbështetet në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

Ky projektligj ka për qëllim përmirësimin e mëtejshëm të politikave tatimore, në funksion të forcimit të drejtësisë dhe neutralitetit fiskal, rritjes së progresivitetit të sistemit tatimor dhe sigurimit të një shpërndarjeje më të balancuar të barrës tatimore ndërmjet kategorive të ndryshme të të ardhurave dhe tatimpaguesve.

Në këtë kuadër, ndryshimet e propozuara përfshijnë rishikimin e normës së tatimit mbi të ardhurat nga dividendët, saktësimin e përkufizimit të dividendit me qëllim parandalimin e shmangies së detyrimeve tatimore nëpërmjet shpërndarjeve të tërthorta të fitimit, përshtatjen e strukturës progresive të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, si dhe saktësimin dhe unifikimin e trajtimit tatimor favorizues për kategori të caktuara individësh. Njëkohësisht, projektligji synon thjeshtimin e procedurave të përmbushjes së detyrimeve tatimore dhe reduktimin e barrës administrative për tatimpaguesit, nëpërmjet eliminimit të detyrimit për dorëzimin e dyfishtë të pasqyrave financiare pranë administratës tatimore dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Konkretisht, projektligji synon:

- saktësimin, zgjerimin dhe unifikimin e trajtimit tatimor favorizues për individët dhe të vetëpunësuarit e vetëm, që kanë statusin e personit të verbër, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, personit me surdomutizëm dhe invalidit të punës, duke siguruar vijimësinë e lehtësive për kategoritë që i kanë gëzuar ato më parë dhe një trajtim të njëjtë tatimor për kategoritë e përfshira në këtë dispozitë;
- unifikimin në 15% të normës tatimore për të ardhurat nga dividendi me të ardhurat e tjera pasive nga investimi dhe tatimin e mbajtur në burim (neni 24, pika 3, neni 41 dhe neni 59), duke e rritur normën e tatimit mbi dividendin nga 8% në 15%, me synim reduktimin e diferencës ndërmjet

tatimit të të ardhurave nga kapitali dhe atyre nga punësimi, parandalimin e arbitrazhit tatimor dhe nxitjen e riinvestimit të fitimeve;

- saktësimin në përkufizimin e dividendit (neni 3, pika 19), duke qartësuar trajtimin tatimor të shumave që u jepen ortakëve apo aksionarëve në formën e paradhënieve, huave ose formave të tjera të financimit, kur këto shuma nuk përfaqësojnë transaksione financiare reale ose shlyerje detyrimesh, por në përmbajtjen e tyre ekonomike përbëjnë shpërndarje të tërthortë të fitimit, me qëllim parandalimin e shmangies së tatimit mbi dividendin dhe garantimin e një trajtimi tatimor të njëjtë, pavarësisht formës juridike të transaksionit;
- rishikimin e formulës dhe të shkallës progresive të tatimit mbi të ardhurat personale (TAP) nga punësimi (neni 24, pika 1), ku parashikohet lehtësimi i barrës tatimore për shtresën e mesme dhe profesionistët e kualifikuar përmes rritjes së pragut të fashës së parë tatimore (që tatohet me normën 13%) nga paga bruto 200 000 lekë/muaj në 300 000 lekë/muaj (bazë tatimore vjetore nga 2 040 000 lekë në vit në 3 240 000 lekë në vit, pasi është aplikuar zbritja tatimore në bazë të nenit 22 në një shumë prej 360 000 lekësh në vit), zbatimi i normës tatimore prej 23% për fashën e pagës bruto nga 300 001 lekë/muaj deri në 700 000 lekë/muaj (bazë tatimore vjetore nga 3 240 001 lekë deri në 8 040 000 lekë), si dhe vendosja e një shkalle të tretë progresive me normë margjinale 30% për individët me të ardhura më të larta, konkretisht për pagat bruto mbi 700 000 lekë/muaj (bazë tatimore vjetore mbi 8 040 000 lekë në vit). Ky ndryshim synon një shpërndarje më të drejtë dhe të balancuar të barrës tatimore mbi të ardhurat nga punësimi, duke lehtësuar tatimin për shtresën e mesme dhe profesionistët e kualifikuar, si dhe duke forcuar progresivitetin e sistemit, në përputhje me aftësinë paguese të individëve.
- eliminimin e dorëzimit të dyfishtë të pasqyrave financiare pranë administratës tatimore, duke filluar me pasqyrat financiare, që i përkasin vitit tatimor 2027, për tatimpaguesit, që kanë detyrimin për depozitimin e tyre pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. QKB-ja ia përcjell administratës tatimore elektronikisht.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, ka për qëllim:

1. lehtësimin e barrës tatimore për kategori të caktuara individësh me aftësi të kufizuar, duke synuar saktësimin, zgjerimin dhe unifikimin e trajtimit tatimor favorizues për të ardhurat e individëve dhe të vetëpunësuarve të vetëm, që kanë statusin e personit të verbër, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, personit me surdomutizëm dhe invalidit të punës.

Në lidhje me saktësimin, zgjerimin dhe unifikimin e trajtimit tatimor favorizues për kategoritë e sipërpërmendura, ndryshimi i propozuar synon, nga njëra anë, të sigurojë vijimësinë e lehtësive tatimore për kategoritë që i kanë gëzuar ato më parë sipas legjislacionit përkatës dhe, nga ana tjetër, të shtrijë këtë trajtim edhe për kategoritë e tjera të përfshira në dispozitë, duke përcaktuar një trajtim të njëjtë në ligjin për tatimin mbi të ardhurat. Njëkohësisht, ky ndryshim synon lehtësimin e barrës tatimore për kategori, të cilat përballen me kufizime më të mëdha në pjesëmarrjen në tregun e punës, si dhe me nevoja dhe kosto shtesë në jetën e përditshme.

Në nivel ndërkombëtar, pjesëmarrja në tregun e punës e personave me aftësi të kufizuara vijon të mbetet ndjeshëm më e ulët krahasuar me personat pa aftësi të kufizuara. Për nxitjen e punësimit të kësaj kategorie, OECD-ja evidenton përdorimin në vende të ndryshme të stimujve tatimorë, si: kreditë tatimore, zbritjet tatimore apo rritja e pragut të të ardhurave të patatueshme, si instrumente që mund të mbështesin pjesëmarrjen e kësaj kategorie në tregun e punës. Ndryshimi i propozuar synon, në këtë kuadër, të rrisë të ardhurat neto të disponueshme të këtyre individëve, me qëllim nxitjen e punësimit dhe vetëpunësimit të tyre.

Kjo masë është gjithashtu në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila, në nenin 27, parashikon marrjen e masave për promovimin e mundësive për punësim, vetëpunësim, sipërmarrje dhe fillimin e një aktiviteti ekonomik nga personat me aftësi të kufizuara. Konventa parashikon gjithashtu promovimin e punësimit në sektorin privat nëpërmjet politikave dhe masave të përshtatshme, përfshirë masa stimuluese.

Në këtë mënyrë, ndryshimi i propozuar synon jo vetëm lehtësimin e barrës tatimore, por edhe mbështetjen e pavarësisë ekonomike dhe të përfshirjes më të madhe të këtyre kategorive në tregun e punës e në aktivitetin ekonomik.

2. Unifikimi në 15% i normës tatimore për të ardhurat nga dividendi me të ardhurat e tjera pasive nga investimi dhe tatimin në burim, si dhe saktësimi i përkufizimit të tij për parandalimin e shmangies tatimore (ndryshimi i nenit 3, pika 19, neni 24, pika 3, nenit 41 dhe nenit 59).

Një tjetër ndryshim thelbësor i propozuar nëpërmjet këtij projektligji lidhet me rishikimin e normës së tatimit mbi të ardhurat nga dividendët, duke e rritur atë nga 8% në 15% në të tria dispozitat e ligjit nr.29/2023, që rregullojnë taksimin e dividendit:

- në nenin 24, pika 3 (neni 2, pika 2, i projektligjit), ku shkronjat "a" (8% për dividendët) dhe "b" (15% për çdo zë tjetër të të ardhurave nga investimi) shkrihen në një dispozitë të vetme të unifikuar: "3. Të ardhurat nga investimi tatohen me normën 15%.";
- në nenin 41 (neni 5 i projektligjit), ku norma tatimore për dividendët përcaktohet në 15%, pa zbritur asnjë kosto; dhe
- në nenin 59 (neni 7 i projektligjit), ku hiqet ndarja e mëparshme prej 8% për dividendët dhe unifikohet në një shkallë të vetme prej 15% norma e tatimit të mbajtur në burim për të gjitha të ardhurat dhe pagesat sipas nenit 58 të ligjit.

Kjo ndërhyrje legjislative mbështetet në argumentet e mëposhtme:

- Harmonizimi i plotë brenda sistemit të të ardhurave nga investimi dhe frenimi i arbitrazhit tatimor: Aktualisht, legjislacioni tatimor parashikon aplikimin e normës tatimore prej 8% për të ardhurat nga dividendët, ndërkohë që të gjitha kategoritë e tjera të të ardhurave nga investimet (interesat, qiratë, honorarët, fitimet kapitale nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme, titujve, instrumenteve financiare dhe kriptoaseteve) dhe pagesat, objekt i tatimit, në burim tatohen me normën 15%, ndërsa të ardhurat nga punësimi tatohen me normat progresive 13%, 23% dhe me këtë projektligj deri në 30%. Kjo diferencë e theksuar mund të krijojë stimul për arbitrazh tatimor përmes deklarimit të pagave të ulëta nga ortakët/drejtuesit dhe tërheqjes së fitimeve si dividendë me 8%, ose rikarakterizimit të pagesave të tjera në dividendë. Unifikimi i normës së dividendit në 15% me të gjitha të ardhurat e tjera nga investimi siguron një trajtim konsistent e neutral, eliminon dualitetin e normave në nenin 24(3) dhe nenin 59, si dhe ruan konkurrueshmërinë e plotë rajonale të Shqipërisë (në të njëjtin nivel me Serbinë dhe Malin e Zi, që aplikojnë normën 15%).
- Stimulimi i riinvestimit të fitimeve: Rritja e tatimit mbi shpërndarjen e dividendit nga 8% në 15% dekurajon tërheqjen pasive të kapitalit për konsum dhe nxit shoqëritë tregtare që fitimet e realizuara t'i riinvestojnë në zgjerimin e aktivitetit, modernizimin teknologjik dhe hapjen e vendeve të reja të punës (pasi fitimi i pashpërndarë dhe i riinvestuar nuk i nënshtrohet tatimit mbi dividendin, ashtu siç mbetet në fuqi përjashtimi në pjesëmarrje, sipas nenit 29 të ligjit).
- Efekti i rëndësishëm buxhetor: Bazuar në të dhënat e realizimit dhe parashikimit për vitin 2026, baza e tatueshme vjetore e të ardhurave nga dividendët dhe aksionet arrin në rreth 86,96 miliardë lekë

(86 962 734 452 lekë), ku rritja e normës me 7 pikë përqindjeje (nga 8% në 15%) ka një potencial teorik prej 6 087,39 milionë lekësh. Duke marrë në konsideratë edhe ndikimin e rritjes së normës tatimore në vendimmarrjen e shoqërive për shpërndarjen dhe destinimin e fitimeve (prirjen për të mbajtur e riinvestuar një pjesë më të madhe të fitimit), efekti pozitiv neto në të ardhurat buxhetore vlerësohet në +3 043 695 706 lekë në vit (ose rreth +3,04 miliardë lekë në vit).

Parandalimi i shmangies së tatimit mbi dividendin nëpërmjet shpërndarjeve të tërthorta të fitimit - Në kushtet e rritjes së normës së tatimit mbi dividendin nga 8% në 15%, vlerësohet e nevojshme marrja e masave për parandalimin e praktikave të mundshme të shmangies së detyrimeve tatimore, nëpërmjet përdorimit të formave alternative të shpërndarjes së fitimit.

Për këtë qëllim, projektligji parashikon saktësimin e përkufizimit të dividendit, duke qartësuar se në këtë përkufizim përfshihen edhe shumat e dhëna nga entiteti në favor të ortakëve apo aksionarëve në formën e paradhënieve, huave ose formave të tjera të financimit, kur këto shuma nuk përfaqësojnë transaksione financiare reale ose shlyerje detyrimesh, por në përmbajtjen e tyre ekonomike përbëjnë shpërndarje të tërthortë të fitimit.

Ky ndryshim synon të kufizojë mundësitë për shmangien e tatimit mbi dividendin si rezultat i rritjes së normës tatimore, duke garantuar trajtimin e shpërndarjeve të fitimit sipas përmbajtjes së tyre ekonomike, pavarësisht formës juridike të përdorur.

3. Rishikimi i formulës dhe i shkallës progresive të tatimit mbi të ardhurat personale (TAP) nga punësimi: Rritja e pragut nga 200 000 në 300 000 lekë/muaj dhe vendosja e normës 30% për pagat mbi 700 000 lekë/muaj (ndryshimi i nenit 24, pika 1).

Në kuadrin ligjor aktual, sipas nenit 24, pika 1, dhe nenit 22, pika 1, të ligjit nr.29/2023, tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi llogaritet duke zbritur nga e ardhura bruto zbritjen personale sipas fashave (50 000 lekë/muaj për pagat deri në 50 000 lekë; 35 000 lekë/muaj për pagat 50 001 – 60 000 lekë; dhe 30 000 lekë/muaj apo 360 000 lekë/vit për pagat mbi 60 000 lekë/muaj) dhe duke aplikuar mbi bazën tatimore vjetore dy norma progresive:

- 13% për bazën tatimore vjetore nga 0 deri në 2 040 000 lekë (që në bazë mujore i korrespondon pagës bruto deri në 200 000 lekë/muaj, për të cilën pas zbritjes prej 30 000 lekësh, fasha e tatueshme prej 170 000 lekësh tatohet me 13%, ose 22 100 lekë/muaj); dhe
- 23% për bazën tatimore vjetore mbi 2 040 000 lekë (që në bazë mujore i korrespondon formulës: 22 100 lekë + 23% të shumës mbi 200 000 lekë/muaj).

Me ndryshimin e propozuar në pikën 1, të nenit 24, të ligjit (neni 2, pika 1, i projektligjit), kufiri i bazës tatimore vjetore për aplikimin e normës së parë prej 13% rritet nga 2 040 000 lekë/vit në 3 240 000 lekë/vit, çka korrespondon me rritjen e pragut të pagës bruto mujore nga 200 000 lekë/muaj në 300 000 lekë/muaj (3 600 000 lekë/vit bruto minus 360 000 lekë/vit zbritje personale = 3 240 000 lekë/vit bazë tatimore vjetore, ku formula mujore për fashën pasuese bëhet: 35 100 lekë + 23% të shumës mbi 300 000 lekë/muaj). Njëkohësisht, për pagat bruto mbi 700 000 lekë/muaj (8 400 000 lekë/vit bruto minus 360 000 lekë/vit zbritje personale = 8 040 000 lekë/vit bazë tatimore vjetore) vendoset shkalla e tretë progresive prej 30%. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 22, pika 1, nenit 24, pika 1, dhe nenit 65, pika 1, të ligjit, tabela e re e llogaritjes mujore të tatimit mbi pagën në listëpagesë dhe tabela ligjore vjetore paraqiten, si më poshtë:

SKEMA E RE E LLOGARITJES SË TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE (TAP) NGA PUNËSIMI

E ardhura bruto nga paga (lekë/muaj)	Zbritja personale mujore (Neni 22/1)	Baza tatimore mujore (lekë/muaj)	Baza tatimore vjetore (Neni 24/1)	Formula e llogaritjes mujore të TAP në listëpagesë
0 – 50 000	50 000 lekë	0 lekë	0 lekë	**0% (0 lekë)**
50 001 – 60 000	35 000 lekë	15 001 – 25 000 lekë	180 012 – 300 000 lekë	**13% e shumës mbi 35 000 lekë**
60 001 – 300 000	30 000 lekë	30 001 – 270 000 lekë	360 012 – 3 240 000 lekë	**13% e shumës mbi 30 000 lekë**
300 001 – 700 000	30 000 lekë	270 001 – 670 000 lekë	3 240 001 – 8 040 000 lekë	**35 100 lekë + 23% e shumës mbi 300 000 lekë**
Mbi 700 000	30 000 lekë	Mbi 670 000 lekë	Mbi 8 040 000 lekë	**127 100 lekë + 30% e shumës mbi 700 000 lekë**

TABELA SIPAS NENIT 1 TË PROJEKTLIGJIT (NDRYSHIMI I NENIT 24, PIKA 1)

Fasha	Baza tatimore vjetore (Neni 24, pika 1)	Norma tatimore	Ekuivalenti i bazës tatimore mujore	Ekuivalenti i pagës bruto mujore (me zbritjen 30 000 lekë)
Fasha I	0 – 3 240 000 lekë	**13%**	0 – 270 000 lekë/muaj	Deri në 300 000 lekë/muaj
Fasha II	3 240 001 – 8 040 000 lekë	**23%**	270 001 – 670 000 lekë/muaj	300 001 – 700 000 lekë/muaj
Fasha III	Mbi 8 040 000 lekë	**30%**	Mbi 670 000 lekë/muaj	Mbi 700 000 lekë/muaj

Kjo ndërhyrje legjislative mbështetet në argumentet e mëposhtme:

- Lehtësimi i shtresës së mesme dhe mbështetja e kapitalit njerëzor: Rritja e pragut të aplikimit të normës 23% nga 200 000 në 300 000 lekë/muaj synon të lehtësojë barrën tatimore mbi punën e kualifikuar dhe profesionistët e shtresës së mesme, të cilët, për shkak të rritjes nominale të pagave, kishin kaluar në fashën 23%. Nga kjo masë përfitojnë drejtpërdrejt rreth 25 704 punonjës, të cilëve u ulet tatimi mbi pagën dhe u rriten të ardhurat neto. Për çdo punëmarrës me pagë bruto 300 000

lekë/muaj (dhe për këtë fashë të ardhurash për pagat më të larta), tatimi mujor ulet me 10 000 lekë në muaj (ose 120 000 lekë në vit), pasi fasha nga 200 001 deri në 300 000 lekë tatohet me 13% në vend të 23% (35 100 lekë tatim në vend të 45 100 lekëve, që paguhet aktualisht). Kjo masë nxit formalizimin e pagave të mesme/larta, përmirëson konkurrueshmërinë e tregut vendas të punës për mbajtjen e profesionistëve në vend dhe përkthehet në një lehtësim fiskal për punëmarrësit (efekt negativ për buxhetin) prej -1,98 miliardë lekësh.

- Vendosja e fashës së tretë margjinale prej 30% për pjesën e pagës bruto, që tejkalon 700 000 lekë/muaj (8 040 000 lekë/vit bazë tatimore), me parimin që kush fiton më shumë, paguan më shumë. Nga kjo masë ndikohen drejtpërdrejt rreth 1 293 punonjës, të cilëve u rritet tatimi me 9% (nga 23% në 30%) për të ardhurat bruto mujore mbi 700 000 lekë. Kjo masë ka një efekt pozitiv për buxhetin prej 0,76 miliardë lekësh.

4. Heqja e detyrimit të dorëzimit të pasqyrave financiare tek administrata tatimore, duke filluar me pasqyrat financiare të vitit tatimor 2027 për pasqyrat e dorëzuara pranë QKB-së. QKB-ja do t'ia përcjellë elektronikisht administratës tatimore.

Një tjetër ndryshim i propozuar lidhet me detyrimin për dorëzimin e pasqyrave financiare. Aktualisht, tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të legjislacionit përkatës kanë detyrimin të paraqesin pranë organeve tatimore deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, ndërkohë që tatimpaguesit, që kanë detyrimin për depozitimin e pasqyrave financiare pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, paraqesin të njëjtin dokument edhe pranë këtij institucioni. Në këtë mënyrë, për të njëjtin informacion financiar, tatimpaguesit dorëzojnë të njëjtat pasqyra financiare pranë dy institucioneve.

Me qëllim thjeshtimin e procedurave dhe reduktimin e barrës administrative për tatimpaguesit, propozohet që pasqyrat financiare të paraqiten pranë organeve tatimore vetëm në rastet kur tatimpaguesit nuk kanë detyrimin për depozitimin e tyre pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Për tatimpaguesit, që i depozitojnë pasqyrat financiare pranë QKB-së, informacioni do t'i sigurohet administratës tatimore nga QKB-ja nëpërmjet shkëmbimit elektronik të të dhënave ndërmjet dy institucioneve.

Përjashtimisht, vetëm për pasqyrat financiare të vitit tatimor 2026, tatimpaguesit do të vazhdojnë t'i paraqesin pasqyrat financiare edhe pranë organeve tatimore, sipas procedurave aktuale. Në këtë mënyrë, sigurohet vijimësia e informacionit financiar për administratën tatimore dhe, pas funksionalizimit të shkëmbimit elektronik, eliminohet nevoja që tatimpaguesi të paraqesë të njëjtin dokument pranë dy institucioneve.

Ky ndryshim synon një administrim më të thjeshtë të detyrimeve të raportimit, reduktimin e kohës dhe procedurave të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve nga tatimpaguesit, si dhe rritjen e përdorimit të shkëmbimit elektronik të informacionit ndërmjet institucioneve publike.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 8 nene, të cilat, në mënyrë të përmbledhur, parashikojnë si vijon:

Neni 1 parashikon një saktësimin të përkufizimit të dividendit në pikën 19, të nenit 3, të ligjit, duke qartësuar se në këtë përkufizim përfshihen edhe shumat e dhëna nga entiteti në favor të ortakëve apo aksionarëve, në formën e paradhënieve, huave ose formave të tjera të financimit, kur këto shuma nuk përfaqësojnë transaksione financiare reale ose shlyerje detyrimesh, por në përmbajtjen e tyre ekonomike përbëjnë shpërndarje të tërthortë të fitimit. Ky saktësim synon të shmangë paqartësitë në interpretimin dhe zbatimin e dispozitës, si dhe të parandalojë shmangien e tatimit mbi dividendin.

Neni 2 parashikon përjashtimin nga tatimi mbi të ardhurat personale i të ardhurave të individëve dhe të vetëpunësuarve të vetëm, që kanë statusin e personit të verbër, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, personit me surdomutizëm dhe invalidit të punës.

Neni 3 parashikon dy ndryshime në nenin 24 të ligjit:

1. Pika 1, e nenit 24, ndryshohet duke përcaktuar shkallën progresive me tri fasha për të ardhurat e tatueshme nga punësimi:

- 13% për bazën tatimore vjetore nga 0 deri në 3 240 000 lekë (që i korrespondon pagës bruto deri në 300 000 lekë/muaj, pas zbritjes personale sipas shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 22);
- 23% për bazën tatimore vjetore nga 3 240 001 deri në 8 040 000 lekë (që i korrespondon pagës bruto nga 300 001 deri në 700 000 lekë/muaj, ku në listëpagesë tatimi llogaritet me formulën: 35 100 lekë + 23% të shumës mbi 300 000 lekë/muaj); dhe
- 30% për bazën tatimore vjetore mbi 8 040 000 lekë (që i korrespondon pagës bruto mbi 700 000 lekë/muaj, ku në listëpagesë tatimi llogaritet me formulën: 127 100 lekë + 30% të shumës mbi 700 000 lekë/muaj).

2. Pika 3, e nenit 24, ndryshohet duke unifikuar në masën 15% normën tatimore për të gjitha të ardhurat nga investimi (përfshirë të ardhurat nga dividendët, të cilat rriten nga 8% në 15%).

Në nenin 4 saktësohet që pasqyrat e raportimit financiar të paraqiten pranë organeve tatimore, sipas përcaktimeve të pikës 5, të nenit 61, të këtij ligji.

Neni 5 parashikon ndryshimin e fjalisë së dytë, të nenit 41, të ligjit, duke përcaktuar se norma tatimore për dividendët është 15%, pa zbritur asnjë kosto.

Neni 6 parashikon ndryshimin e nenit 59 ("Norma e mbajtjes së tatimit në burim") të ligjit, duke unifikuar në masën 15% normën e tatimit të mbajtur në burim mbi të gjitha të ardhurat dhe pagesat sipas nenit 58 të ligjit (përfshirë dividendët, për të cilët norma rritet nga 8% në 15%).

Neni 7 parashikon ndryshimin e pikës 5, të nenit 61, duke përcaktuar që pasqyrat financiare të paraqiten pranë organeve tatimore vetëm nga tatimpaguesit, që nuk kanë detyrimin për depozitimin e tyre pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Tatimpaguesit, që kanë këtë detyrim, i depozitojnë pasqyrat financiare vetëm pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Përjashtimisht, vetëm pasqyrat financiare të vitit tatimor 2026 do të deklarohen edhe pranë administratës tatimore.

Neni 8 përcakton hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe fillimin e efekteve nga data 1 janar 2027.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj parashikohet të sjellë efekte financiare në buxhetin e shtetit, si më poshtë vijon:

- Për përjashtimin nga tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi për kategoritë e personave me aftësi të kufizuar, efekti nuk është i ndjeshëm për arsye se në bazë të të dhënave të administratës tatimore ka një numër të vogël aktual të të punësuarve;
- Për përjashtimin nga tatimi mbi të ardhurat e biznesit, për të vetëpunësuarit e vetëm, efekti do të jetë në mars 2028, kur të dorëzohet deklarata e të ardhurave personale nga biznesi për vitin tatimor 2027. Kategoria "i vetëpunësuar i vetëm" është e përcaktuar në udhëzimin përkatës për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe njihet si kategori e veçantë në sistemin e deklarimit të listëpagesës. Vlerësimi më i saktë do të jetë kur të hartohet buxheti i vitit 2028, për të vlerësuar numrin e kësaj kategorie gjatë vitit 2027;
- Rritja e normës së tatimit mbi dividendin nga 8% në 15%, duke marrë në konsideratë edhe ndikimin e rritjes së normës tatimore në vendimmarrjen e shoqërive për shpërndarjen e fitimeve, gjeneron një efekt pozitiv vjetor në buxhetin e shtetit prej +3,04 miliardë lekësh në vit.
- Rishikimi i formulës së tatimit mbi të ardhurat personale (TAP) nga punësimi: Rritja e pragut të fashës 13% nga 200 000 në 300 000 lekë/muaj përkthehet në një lehtësim tatimor të drejtpërdrejtë për 25 704 punonjës në vlerën rreth -1,98 miliardë lekë në vit, kosto, e cila zbutet më tej nga të ardhurat shtesë prej 0,76 miliardë lekësh në vit, që gjeneron aplikimi i normës margjinale prej 3% për pagat bruto mbi 700 000 lekë/muaj, pra, me një efekt neto prej -1.22 miliardë lekësh në vit.

Në total, ndryshimet e propozuara parashikohen të gjenerojnë një efekt neto pozitiv në të ardhurat e buxhetit të shtetit prej rreth 1.82 miliardë lekësh në vit, bazuar në efektet financiare të vlerësuara për politikat e mësipërme, ndërkohë që efektet e lehtësive tatimore për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara dhe të ndryshimeve në skemën e sponsorizimeve do të vlerësohen më saktë gjatë hartimit të buxhetit të vitit 2028.

KËSHILLI I MINISTRAVE